

AKT - THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“THJESHT”

Sot, më datë 30.04.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), unë i nënshkruari sa më poshtë në cilësinë e themeluesit :

- Elton Demerxhiu, i biri i Bujar dhe Lindita, i datëlindjes 20.10.1986, lindur në Krujë dhe banues në Tiranë në adresën Rruga “E Dibrës”, Njësia Administrative Nr. 8, mbajtës i letërnjoftimit Nr. I61020012B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

bazuar në nenin 4 të Ligjit Nr. 10031 datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor gjyqësor Privat” i ndryshuar, dispozitat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 10081 date 23.02.2009 “Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet ne Republikën e Shqipërisë”, *vendosa të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin “THJESHT”*, sipas parashikimeve të mëposhtme:

NENI 1

Emri i shoqërisë

Emërtimi i plotë i shoqërisë tregtare është “THJESHT” SHPK.

NENI 2

Selia e shoqërisë

Shoqëria do të ketë selinë e saj në adresën Rruga “E Dibrës”, Nd. 126, H1, Ap. 25, Njësia Administrative Nr. 8, 1017, Tiranë, Shqipëri.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj *“Ekzekutimin e titujve ekzekutiv”*.



NENI 4

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të përbëhet nga kontributi në të holla i ortakut themelues me vlerë totale prej 10,000 (dhjetë mijë) LEKE. Kapitali themeltar prej 10,000 (dhjetë mijë) LEKE do të përbëjë një kuotë të vetme me vlerë nominale prej 10,000 (dhjetë mijë) LEKE ose 100 % pjesë në kapitalin themeltar, e cila do të zotërohet i vetëm nga ortaku themelues Elton Demerxhiu.

Kapitali themeltar do të shlyhet nga ortaku themelues në llogarinë bankare të Shoqërisë, pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë QKB dhe mund të ndryshohet (përcaktohet) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 6

Organet Drejtuese

Ne zbatim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, organet drejtuese të Shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe drejtues i veprimtarisë së përditshme të shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtyre organeve rregullohet dhe ushtrohet sipas parashikimeve të Statutit të shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi.

Shoqëria do të përfaqësohet ligjërisht nga Administratori i saj z. **Elton Demerxhiu** i biri i Bujar dhe Lindita, lindur në Krujë dhe banues në Tiranë në adresën Rruga “E Dibrës”, Njësia Administrative Nr. 8, mbajtës i letërnjoftimit Nr. I61020012B, madhor, me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar.



NENI 7

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

Me nënshkrimin e këtij Akt Themelimi, ortaku themelues detyrohet që të hartojë dhe nënshkruajë Statutin e Shoqërisë, një kopje e te cilit do të depozitohet në QKB.

Ngarkohet Administratori i shoqërisë që të kryejë procedurat e Rregjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombetare të Biznesit (QKB).

Detyrimin për regjistrimin e shoqërisë në QKB, Administratori mund ta kryejë personalisht ose nëpërmjet personave të caktuar dhe autorizuar prej tij.

ORTAKU THEMELUES
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“THJESHT”

Elton Demexhiu

Elton Demexhiu
